



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 03-349

13.11.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 14 të Ligjit për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13 dhe 13/14), pika 15 e Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve, ark.nr.01-4443/1 datë 9.10.2018, pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1, datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3653/1 datë 4.10.2023 dhe Konkluzionin nr.02-4077/6 datë 10.11.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 36-të mbajtur më 10.11.2023, miratoi si vijon

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET EF-EM 90.3 - SPORTSKO RADIO SHPKNJP eksport-import Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 14 të Ligjit për Media (LM), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor në radio transmetuar më 5 shtator 2023, si në shpicën lajmëruese dhe në shpicën çlajmëruese nuk i publikoi të dhënat për impresium në tërësinë e lajmeve në radio, me titull: "Lajmet sportive në 90.3 EF-EM".

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3653/1 datë 4.10. 2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET EF-EM 90,3-SPORTSKO RADIO SHPKNJP eksport-import Shkup, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratim llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente të kryejë mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave në aspekt të përputhshmërisë së punës (veprimtarisë) së tyre me detyrimet e përcaktuara me nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masën - vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen gjithashtu dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 14 të LM, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës individual të përmbajtjes (për shembul, një mostër e medias së shkruar dhe emisioni televiziv) të sigurojë publikimin e të dhënave të mëposhtme: emër dhe adresë të selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emri i personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, pra redaktorët në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emrin dhe adresën e shtypshkronjës dhe datën e botimit ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, kur kemi të bëjmë me media të shtypit. Për transmetuesit, detyrimi i lartpërmendur zbatohet në atë mënyrë që të dhënat publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audi vizuale. Botuesi i medias është i detyruar të publikojë në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin e autorit të shtojcës (fragmentit) të publikuar, emrin dhe mbiemrin e personit, gjegjësisht të shoqërisë që ka të drejtën e autorit për përmbajtjet e publikuara, përveç atyre të shtypura dhe programeve në radio, datën e produksionit (muajin dhe vitin) kur kemi të bëjmë me vepër audio/audi vizuale, origjinën e veprës audio/audi vizuale, dhe nëse vepra është krijuar nga produksion i pavarur dhe informacione për të, emri i personi juridik, pra emrin dhe mbiemrin e personit që e ruan atë të mirën e përdorur kulturore ose vepër arkivore, përkatësisht reproduksionin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga ku është marrë (fragmenti) shtojca e programit ose klipi nga shtojca e programit, përveç rasteve kur me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me pikën 15 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion ark.nr.01-4443/1 datë 9.10.2018 (Udhëzime), në rastet kur transmetohen njësitë editoriale të lajmeve të shkurtra (lajme flesh më pak se 5 minuta), mjafton që në shpicën çlajmëruese të publikohen të dhënat e mëposhtme: emrin dhe mbiemrin e redaktorit të edicionit konkret të lajmeve, emrin dhe mbiemrin e prezantuesit/gazetarit, emrin dhe mbiemrin e përgjegjësit të drejtimit teknik të emisionit, data e produksionit (ditën, muajin dhe vitin), emrin e subjekti tjetër nga i cili është marrë shtojca e caktuar ose pjesë e shtojcës, përveç rasteve kur me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, Agjencia, nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 4 tetor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor në radio të EF-EM 90.3 - SPORTSKO RADIO SHPKNJP eksport – import Shkup, transmetuar më 5 shtator 2023, në nivel rajonal, nga ku konstatoi shkelje të nenit 14 të LM. Gjegjësisht me mbikëqyrjen është konstatuar se në kundërshtim me pikën 15 të Udhëzimit në tërësinë e lajmeve të shkurtra në radio me titull: "Lajme sportive në 90,3 FM", si në shpicën çlajmëruese dhe në atë çlajmëruese nuk janë publikuar: emri dhe mbiemri i redaktorit të edicionit konkret të lajmeve; emrin dhe mbiemrin e prezantuesit/gazetarit; emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës për udhëheqjen teknike të emisionit; datën e produksionit (ditën, muajin dhe vitin) dhe emrin e subjektit tjetër nga i cili është marrë fragmenti (shtojca) e caktuar ose pjesë e shtojcës, përveç rasteve kur me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar me datën, titullin e emisionit, periudhën e transmetimit (fillimin dhe përfundimin) dhe përshkrim në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3653/1 datë 4.10.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar EF-EM 90.3 - SPORTSKO RADIO SHPKNJP eksport-import Shkup, më 9.10.2023, dërgoi Shkresë me Nr. ynë ark.10-3653/2 datë 9.10.2023, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3653/1 datë 4.10.202, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 10.10.2023. Në afatin e parashikuar EF-EM 90.3 - SPORTSKO RADIO SHPKNJP eksport - import Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 10.11.2023, e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi EF-EM 90.3 - SPORTSKO RADIO SHPKNJP eksport - import Shkup t'i shqiptoi masën - vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 të LM, pika 15 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion në dispozicion të përdoruesve, pika

7 dhe 14 nga Rregullorja për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendime të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3653/ 1 datë 4.10.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4077/6, datë 10.11.2023, për konstatimit të mosrespektimit të dispozitave nga LM, përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 10.11.2023, miratoi Aktvendim me të cilin paralajmëron publikisht EF-EM 90.3 - SPORTSKO RADIO SHPKNJP eksport-import Shkup, dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LM. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 nga LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3653/1 datë 4.10.2023 .

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.